

## Thirrje nga Perform Europe për organizatat, kompanitë e arteve skenike, artistët, grupimet, vendet e shfaqjeve dhe festivalet

*Të gjitha udhëzimet dhe kriteret për aplikimin për thirrjen nga Perform Europe janë të disponueshme në Anglisht [këtë faqe](#).*

Perform Europe është një skemë pilot e financuar nga Komisioni Evropian. Qëllimi i saj është të mbështesë eksperimentet për t'i bërë më të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës turnetë e veprave të artit skenik në vendet anëtarë të programit Creative Europe. Lexoni më shumë [këtu](#).

Aktualisht, jemi duke u përgatitur të fillojmë me testimin e skemës së dhënies së granteve të Perform Europe. Kjo do të ndodhë në dy faza:

1) Në **fazën e parë, producentët** (artistë, grupime, organizata, kompani dhe prezantues që kanë realizuar një vepër artistike) dhe **prezantuesit** (festivale, vende shfaqjesh dhe organizata të tjera që ofrojnë një kontekst prezantues) aplikojnë për të qenë pjesë e procesit të Perform Europe për të mësuar dhe rrjetëzuar bashkarisht të mbështetur nga platforma e saj dixhitale. **Thirrja është e detajuar më poshtë dhe do të hapet për aplikime më 15 Qershor**. Aplikantë e zgjedhur në këtë fazë, do të ftohen të kalojnë në fazën e dytë të procesit.

2) Në **fazën e dytë**, gjatë dhe pas marrjes pjesë në procesin e të mësuarit dhe rrjetëzimit, aplikantët do të krijojnë partneritete ndërmjet njëri-tjetrit, bashkëpropozime për turne dhe shpërndarje, dhe do të aplikojnë për grantet e Perform Europe. Buxheti total në dispozicion është 1,5 milion euro. Shumat e grantit do të shkojnë nga 10 000 euro në 100 000 euro. **Thirrja e dytë do të publikohet në fund të korrikut vetëm për ata që janë zgjedhur në fazën e parë** (shih një kronologji më të detajuar të procesit të aplikimit për Perform Europe në [faqen e internetit të Perform Europe](#))

**Aplikimi për fazën e parë do të jetë i hapur nga 15 qershor deri më 7 korrik në platformën dixhitale Perform Europe. Meqenëse kjo thirrje e parë do të jetë e hapur vetëm për tre javë, ju mund të filloni të përgatiteni që sot. Më poshtë do të gjeni më shumë detaje se për çfarë bëhet fjalë.**

### **Kë po kërkojmë në fazën e parë?**

Organizata dhe profesionistë të pavarur që:

- punojnë në artet skenike: teatër, kërcim, shfaqje (përfshirë performancat amatore), cirk dhe artet e rrugës. Kini parasysh që përveç teatrit muzikor; performancat e muzikës të drejtpërdrejte (përfshirë opera dheshfaqje muzike ) nuk mbulohen nga Perform Europe.
- **për producentët:** të kenë një vepër artistike ose iniciativa artistike që do të dëshironin t'i dërgonin në shtete të tjera fizikisht, dixhitalisht ose në mënyrë të përzier, midis tetorit 2021 dhe fundit të qershorit 2022;
- **për prezantuesit:** të kenë një festival ose një hapësirë, ose kontekst tjetër që do të prezantojë një vepër artistike nga një vend tjetër midis tetorit 2021 dhe fundit të qershorit 2022;
- janë të vendosur në një nga vendet pjesëtare të programit Creative Europe\* (shih listën e plotë në [këtë faqe](#)) ose në Mbretërinë e Bashkuar;
- të kenë një vizion bashkëpunimi ndërkufitar me anë ndarjes së burimeve, praktikimit të drejtësisë dhe solidaritetit;
- po zbatojnë tashmë praktika alternative dhe inovative të turneut dhe shpërndarjes dhe mund ta demonstrojnë atë, dhe gjithashtu ata që
- janë të etur për të përtërirë praktikatat e tyre dhe kanë një vizion se si ta bëjnë këtë, por mund të ndeshin shumë kufizime.

Ne veçanërisht inkurajojmë të aplikojnë për këtë thirrje prezantuesit dhe producentët që kanë më pak shikueshmëri në skenën artistike ndërkufitare. Mirëpresim aplikime nga gra, artistë dhe organizata me qendër në zonat rurale, ato që kanë prejardhje të pa favorshme socio-ekonomike ose etnike, që identifikohen si LGBTQIA+, me aftësi të kufizuara dhe persona të tjerë që identifikohen si pjesë e një grupi të nën përfaqësuar brenda fushës së artit skenik.

## Çfarë do t'ju kërkohet në fazën e parë që hapet me 15 qershor?

- Informacione të përgjithshme rreth organizatës tuaj;
- Informacione të përgjithshme në lidhje me **punët artistike (për producentët)** ose **prezantimi i konteksteve, të tilla si festivali, vende shfaqjesh, hapësira e jashtme (për prezantuesit)**, të cilat do të doni të jenë pjesë e një propozimi bashkëpunimi;
- Vizioni dhe idetë tuaja mbi mënyrat e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të sjellë punët artistike pranë njerëzve dhe vendeve (400 fjalë);
- Si përshtatet puna juaj artistike/konteksti i prezantimit, që është pjesë e aplikimit tuaj, me këtë vizion (250 fjalë);
- Çfarë do të donit të përfitoni duke qenë pjesë e një partneriteti të dhënë nga Perform Europe (250 fjalë) dhe çfarë do të ishit të gatshëm të ndanit (aftësi, njohuri, para, shikueshmëri, infrastrukturë, përvojë etj.) (300 fjalë)

Ju lutemi, kini parasysh se të gjitha këto informacione do të kërkohen **në Anglisht**.

**Si mund të aplikoni?** Thirrja do të hapet **më 15 qershor 2021**. Ju lutemi të abonoheni në buletin tonë për të marrë njoftime. Ndërkohë, ju mund të filloni tashmë të përgatiteni duke reflektuar mbi pikat e mësipërme dhe gjithashtu t'i paraprini fazës së dytë të aplikimit.

Në [faqen e internetit të Perform Europe](#) do të gjeni më shumë informacione për fazën e parë, fazën e dytë dhe kronologjinë e Perform Europe, në gjuhën angleze.